

Emri i Lëndës : Anglisht e Avancuar II							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
EFL 104	C	Pranverë	5.00	0.00	0.00	5.00	5.00
Lektori		Elsuida Hoxhaj, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Kjo lëndë do të pasqyrojë jetën sociale dhe të përditshme si pjesë e rëndësishme e komunikimit personal, zyrtar, politik apo korporativ në shoqërinë tonë. Duke përmbledhur qasjet kryesore bashkë me përkufizimet studentët do përfitojnë njohuritë bazë mbi marrëdhëniet me shoqërinë ku jetojnë dhe do të përvetësojnë gjuhën e huaj duke mos pasur pengesë të shprehen apo të përshtaten me përdorimin e gjuhës angleze si në kontekst të përgjithshëm ashtu dhe bazuar në fushën e tyre të studimit.					
Objektivat		1-Dhënia e njohurive të thelluara mbi gjuhën angleze në përdorimin e përditshëm lidhur me individin dhe shoqërinë. 2-Shtjellimi i koncepteve dhe qasje kryesore mbi fushën e gjuhës angleze dhe paisja me aftësitë për aplikimin e këtyre koncepteve në praktikë. 3-Aftësimi i studentëve në përdorimin e gjuhës në mënyrë të avancuar në kontekst akademik.					
Konceptet Kryesore		1. Mardhëniet, kultura dhe identiteti 2. Politika, mardhëniet dhe qytetërimi 3. Shkenca dhe kërkimi shkencor 4. Shëndeti dhe sëmundjet 5. Media dhe lajmet 6. Biznesi dhe ekonomia 7. Historia dhe trendet e kohës					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Unit 1 Qytetet fq. 6-13. Në këtë mësim studenti mëson si: • të flasë rreth përshtypjes së parë dhe njerëzve që njih • të përshkruajë aspektet e qyteteve dhe jetesës aty • të tregojë histori ose mite rreth qyteteve dhe jetës në to • të flasë problemeve urbane dhe të propozojë zgjidhje						
2	Unit 2 Marrëdhëniet fq. 14-23. Në këtë mësim studenti mëson si: • të përshkruajë ndërtesat dhe zona të caktuara më në detaje • të flasë rreth festivaleve kulturore dhe karnavaleve • të përshkruajë qytetin, njerëzit dhe kulturën e vendit që viziton						
3	Unit 3 Kultura dhe identiteti fq. 24-31. Në këtë mësim studenti mëson si: • të flasë rreth aspekteve kulturore dhe shoqërore • të diskutojë mbi identitetin personal dhe nacional • të shprehë mendimet dhe emocionet në mënyrë empatike						
4	Unit 4 Politika fq. 32-41. Në këtë mësim studenti mëson si: • të përshkruajë politikanët dhe cilësitë e tyre • të diskutojë mbi çështjet politike dhe qëndrimet personale • të flasë rreth votimeve dhe zgjedhjeve						
5	Unit 5 Të dalësh me miqtë fq. 42-49. Në këtë mësim studenti mëson si: • të flasë për atë që bën në kohën e lirë • të diskutojë mbi daljet me shoqërinë • të përshkruajë aktivitetet sociale • të përdorë të shkuarën në mënyrë të saktë						
6	Unit 6 Konfliktet dhe zgjidhjet fq. 50-59. Në këtë mësim studenti mëson si: • të flasë për argumentimin e saktë në rast konflikti • të diskutojë problematikat dhe zgjidhjet që ofron • të kuptojë përdorimin e metaforave						
7	Unit 7 Kërkimi Shkencor fq. 60-67 & Unit 8 Natyra fq. 68-77. Në këtë mësim studenti mëson si: • të flasë për motin dhe katastrofat natyrore • të diskutojë mbi çështjet e lidhura me kafshët dhe bimët dhe habitatin e tyre • të diskutojë mbi kërkimin shkencor dhe avancimet e kësaj fushe • të flasë rreth shkencës, fakteve dhe të përdorë mirë tabelat, anketimet dhe grafikët						
8	Provimi gjysmë final						

9	Unit 9 Puna fq. 78-85. Në këtë mësim studenti mëson si: • të flasë për avantazhet dhe disavantazhet e punës • të diskutojë mbi eksperiencat e ndryshme në punë • të flasë rreth termave të punësimit dhe kushteve të punës
10	Unit 10 Shëndeti dhe sëmundjet fq. 86-95. Në këtë mësim studenti mëson si: • të përshkruajë procedura të ndryshme mjekësore dhe kirurgjikale • të diskutojë mbi sistemin mjekësor • të diskutojë mbi problematikat që hasin mjekët • të përshkruajë gjërat që bën mendja dhe trupi i njeriut
11	Unit 11 Lojrat dhe sporti fq. 96-103. Në këtë mësim studenti mëson si: • të flasë rreth sporteve që shikon ose bën • të diskutojë rreth lojrave online • të njohi dhe ta përdorë ironinë • të flasë rreth ideve me struktura të përbëra fjalish
12	Unit 12 Historia fq. 104-113. Në këtë mësim studenti mëson si: • të flasë rreth historisë dhe ngjarjeve kyçe në shoqëri • të diskutojë duke përdorur gjuhë përshkruuese dhe krahasuese • të japë prezantime rreth një eventi historik
13	Unit 13 Lajmet dhe media fq. 114-121. Në këtë mësim studenti mëson si: • të flasë rreth mediave dhe lajmeve • të raportojë ngjarjet ose lajmet • të përdorë pyetjet retorike • të flasë rreth njerëzve dhe lajmeve tyre të reja
14	Unit 14 Biznesi dhe ekonomia fq. 122-131. Në këtë mësim studenti mëson si: • të flasë rreth problemeve të lidhura me financat personale • të diskutojë mundësitë për biznes • të flasë rreth bankave dhe përdorimit të parasë
15	Unit 15 Trendet fq. 132-139 & Unit 16 Rreziqet fq. 140-149. Në këtë mësim studenti mëson si: • të flasë për trendet në stil ose në veshje • të diskutojë mbi industrinë e modës • të flasë rreth aksidenteve dhe lëndimit • të përshkruajë rregullat dhe ligjet në shoqëri • të flasë dhe të mendojë në mënyrë kritike
16	Final Exam
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • Outcomes Second Edition Advanced Student's Book Hugh Dellar Andrew Walkley	
Referenca të tjera • •Outcomes Second Edition Advanced eWorkBook Hugh Dellar Andrew Walkley •Outcomes Advanced Vocabulary and Grammar Builder •English Grammar in Use – fourth edition by Raymond Murphy	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë fjalimet e gjata, leksionet dhe të ndjekin linjat e ndërlikuara të argumentit në anglisht.
2	Studentët do të përdorin gjuhën e biznesit dhe marketingut në gjuhën angleze, duke pasqyruar fjalorin e gjuhës në të cilën studiojnë me terma specifik të fushës.
3	Studentët do të jenë në gjendje të marrin shënime për mënyrën sesi të shkruajnë ese dhe përmbledhje në anglisht.
4	Studentët do të jenë në gjendje të lexojnë artikuj të gjuhës angleze dhe tekste në lidhje me temat bashkëkohore në të cilën shkrimtari miraton një këndvështrim të veçantë ose një qëndrim.
5	Studentët do të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutime akademike në gjuhën angleze, duke paraqitur përshkrime të qarta të detajuara dhe të mbrojnë një pikëpamje të veçantë duke përshkruar avantazhet dhe disavantazhet e ndryshme.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	1	20	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			40
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	5	80
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	0	0
Provimi final	1	0	0
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			122
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.88
ECTS			5.00